Tragjedia e efektives 21-vjeçare që ktheu armën ndaj vetes! Mesazhet e dyshimta me të dashurin e arrestuar

Policia arrestoi të dashurin 28-vjeçar të efektivet të vetëvrarë me armën e shërbimit pasditen e së premtes, me akuzën se ka penguar në zbulimin e së vërtetës që e shtyu të renë drejt vendimit tragjik. I dashuri 7 vite më i madh Endri Nika ka hyrë në banesë pas Aldorjana Loshi nuk i përgjigjej thirrjeve të tij, dhe pasi e pa të pajetë, ka fshirë nga celulari i saj të gjitha mesazhet e shkëmbyera me njëri-tjetrin.

Sokol Dema
25 Maj, 12:13 | **Përditesimi: 25 Maj, 12:22**

Share

Armën të cilën e kishte marrë me betimin për t'i shërbyer të tjerëve, efektivja 21-vjeçare Aldorjana Loshi e përdori kundër vetes. Motivin që e shtyu drejt këtij akti ekstrem, e ka marrë me vete. Por disa elementë që mund ta kenë rënduar gjendjen e saj psikologjike, policia është duke i zbuluar.

I pari që mbërriti në banesën e Aldorjanës të premten pasdite ishte i dashuri i saj. E kishte telefonuar me dhjetëra herë, por nuk kishte marrë asnjë përgjigjje. Me dyshimin se diçka nuk shkon, Endri Nika 28-vjeçar, nga Kamza ku banon, u nis drejt Iagjes së "Ali Demit" në Tiranë. Asnjë përgjigjje pas derës së apartamentit ku 21-vjeçarja jetonte e vetme. Dyshohet të ketë qenë përafërsish ora 18:00 kur efektivja i dha fund jetës, pak para se i dashuri të mbërrinte në shtëpinë e saj. Orët më herët gjatë ditës mendohet të mos kenë qenë të lehta për efektiven e re. Miq e kolegë thonë jashtë kamerave se çifti kishin debate të vazhdueshme.

Kur u përball me tragjedinë i dashuri 7 vite më i madh se Aldorjana, i telefonoi menjëherë policisë i lënduar. Pa dyshuar mbi të, si njeriu i afërt me vajzën, policia e mori në pyetje për të zbuluar më shumë se çfarë mund ta kishte shtyrë Aldorjanën të qëllonte veten. Vetëm në mbrëmje u bindën se i dashuri i polices Endri Nika kishte bërë veprime që e pengojnë zbulimin e së vërtetës të vështirë për tu zbuluar në rastet e vetëvrasjes. Aty e arrestuan. Faktuan se 28-vjeçari sapo kishte parë të dashurën e pajetë në banesë, kish marrë në duar telefonin e saj duke i fshirë të gjitha mesazhet e shkëmbyera me njëri-tjetrin. Të njëjtën gjë bëri edhe nga telefoni i tij. Se çfarë ka dashur të fshehë, këtë pritet që policia ta zbulojë duke tentuar në një rrefim të tijin ose në zbërthimin e aparateve celularë për të rikthyer bisedat e fshira.



LEXO EDHE:
Trafik armësh Kosovë - Shqipëri, kosovarët blinin pistoletat në Serbi, prodhoheshin në Çeki

E reja, punonte në komisariatin numër 5 në Kamëz prej 1 viti. E donte uniformën dhe përpiqej të vepronte me korrektësi pa gabuar në asnjë rast. Pikërisht gjatë kësaj periudhe dyshohet se ka nisur dhe historia e dashurisë me 28-vjeçarin Endri Nika. Babai i tij punonte në të njëjtin komisariat në Kamës, me Aldorjanën.

Në apartamentin me qira në Tiranë, të gjithë e njihnin një vajzë të qetë. Shpesh e kishin parë të konsumonte kafe në lokal e vetme.

Ajo që e kishte vrarë gjithmonë, është mungesa e babait, i cili nuk jetonte. **"Babai është dashuria e parë e çdo vajze"**, mbante shënim në krye të faqes së saj në Instagram, efektivja. Miq, të afërm, kolegë të saj e dashamirës do i japin lamtumirën në një ceremoni në Katedralen e Rrëshenit. Të dielën Aldorjana Loshi do të prehet në vendin e saj të lindjes në fshatin Konaj.

G.M./E.B/Shqiptarja.com

TAG: Tirane | endri nika | vetevrasja | Aldorjana Loshi

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH ZONE

Sondazhi i ditës:
A duhet miratuar rezoluta anti-korrupsion e propozuar nga PS?

PO | JO | NUK E DI

Lajme të tjera

Policja 22-vjeçare vetëvritet me armën e shërbimit, arrestohet i dashuri! Fshiu sms në telefonin e saj sapo e gjeti të pajetë (EMRI)
25 Maj, 10:35

Fatos Çoçoli: Hekurudha Tiranë-Rinas-Durrës: 60 milionë euro në vit fitim për qytetarët!
Fatos Çoçoli
25 Maj, 10:18

Final 4/ Vllaznia 'në tapet', Skënderbeu e mposht 3-2 dhe merr podiumin në Superligë
24 Maj, 21:12

E rëndë në Tiranë, policja 21-vjeçare vetëvritet me armën e shërbimit! Shoqërohet i dashuri, dyshohet se patën debate
24 Maj, 19:08

Surrogacia dhe 'martesa' tek tarraca e bashkisë, qytetarët protestë te sheshi "Skëndërbej": Po shkatërrohet familja
24 Maj, 19:01

Po pastronte armën, gardisti vetëplagoset me armën e shërbimit, çohet tek Trauma
24 Maj, 18:52

FOTO/ Armando Broja 'konfirmon' ftesën për në Euro 2024, sulmuesi mbërrin në Tiranë
24 Maj, 18:33

Finalja e vogël e Superligës pa interes, titullarët e Skënderbeu - Vllaznia! Tifozët braktisin skuadrat
24 Maj, 17:47

Rama: Pista e biçikletave më 1 Qershor i shtohet kryeqytetit
24 Maj, 14:56

Vrau kushëririn në 2015 për 12 mijë lekë, Gjykata e Apelit i ul 3 vite e 8 muaj burg Granit Shehut
24 Maj, 13:25

Zhvatën mijëra qytetarë përmes mashtrimit me mikrokreditë, Gjykata e Tiranës lë në fuqi 9 masat, 4 prej tyre arrest në burg! Përmbaruesi: Jam rrogëtar
Keti Banushi
24 Maj, 13:07

Veliaj pret Presidentin e Rajonit të Pavarur Friuli-Venezia-Giulia në Itali: Tirana, qytet Europian dhe partner strategjik mes dy vendeve
24 Maj, 11:59

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje